



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Datë: 11.11.2025

NJOFTIM

Komuna e Gjakovës njofton se për festat e fundit ka planifikuar që të organizojë tregun e vitit të Ri 2026, në parkun e madh të qytetit, përkatësisht të Platoja.

Në tregun e vitit të ri 2026, do të vendosen shtëpizat dhe procedurat e shpërndarjes do të bëhen nga komisioni profesional, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Komisioni do t'i ndjekë kriteret për ndarjen e hapësirave së bashku me shtëpizat siç përcaktohen me legjislacionin në fuqi, si dhe në bazë të kriterëve në vijim:

1. Formularin e plotësuar me të dhënat e kërkuara;
 2. Kopjen e letërnjoftimit;
 3. Certifikata e regjistrimit të biznesit;
 4. Historiati i biznesit që aplikon;
 5. Veprimtaria që do të zhvillojë;
 6. Vërtetimi nga komuna për përmbushjen e obligimeve të tatimit në pronë;
 7. Vërtetimin e Taksës në Firmë;
 8. Të jetë biznes që operon në Komunën e Gjakovës;
 9. Biznesi duhet të ketë të punësuar së paku një (1) punëtor përveç pronarit;
 10. Vërtetimin që dëshmon se i kanë të përfunduara të gjitha obligimet ndaj ATK-së;
 11. Dokumentin që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, për përfaqësuesin e biznesit jo më e vjetër se 6 muaj).
- *Në rast se dokumentet të cilat kërkohen në aplikim për marrjen në shfrytëzim të shtëpizave nuk janë të kompletuara, kërkesa refuzohet nga ana e komisionit.*
 - *Aplikuesit që kanë obligime tjera të papaguara që do të evidentohen dhe vërtetohen nga komisioni në evidencat e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, kërkesa do u refuzohet nga ana e komisionit.*
 - *Në rast kur aktiviteti i biznesit është ndryshuar gjashtë (6) muajt e fundit, kërkesa do u refuzohet nga ana e komisionit.*

- Në rast se dy apo më shumë aplikues/e aplikojnë për një shtëpizë me të gjitha kushtet e barabarta, atëherë përfituesi caktohet me short ndërmjet këtyre aplikuesve, në praninë e tyre dhe të Komisionit.
- Në rast se dy apo më shumë aplikues/e aplikojnë për një shtëpizë me të gjitha kushtet e barabarta, përparësi ka aplikues/ja e gjinisë me pak e përfaqësuar në parashtrimin e kërkesave.
- Aplikuesit kanë të drejtë të aplikojnë vetëm për një shtëpizë duke përcaktuar në formular sipërfaqen, në rast se evidentohet për dy apo më shumë aplikime kërkesat e tyre refuzohen.
- Komisioni do të përcaktojë lokacionin (vendosjen) e secilit përfitues të shtëpizave sipas planifikimeve për gjithëpërfshirje.

Shtëpizat do të ndahen kryesisht për bizneset që kanë aktivitet kryesor prodhimin e pijeve si dhe shërbimeve me pije. Ndërsa, aktivitete tjera do të vlerësohen nga komisioni me qëllim të gjithëpërfshirjes së aktiviteteve shërbyese dhe prodhuese.

Kompensimi për marrjen në shfrytëzim të një shtëpize sipas sipërfaqes do të jetë:

1. Shtëpiza me sipërfaqe (10) m² - 550 €;
2. Shtëpiza me sipërfaqe (6) m² - 450 €;
3. Shtëpiza me sipërfaqe (4.5) m² - 400 €;
4. Shtëpiza me sipërfaqe (3) m² - 300 €.

Të gjithë shfrytëzuesit obligohen që të mbajnë të hapur shtëpizat nga ora 12:00 deri në orën 24:00 çdo ditë, në të kundërtën Komuna do të shkëputë kontratën dhe do të ndërmerr masa ligjore.

Afati për parashtrimin e kërkesave për marrjen në shfrytëzim të hapësirave – shtëpizave fillon nga data **12.11.2025** dhe përfundon me datën **18.11.2025**, në orën 15:00.

Me respekt!

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

